



Përmbledhje e Aktivitetit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit (Java 8)

21 – 25 shkurt 2022

21 shkurt 2022

Ukraina - KS zhvilloi një takim urgjent mbi situatën në Ukrainë. Takimi u kërkua nga Ukraina, mbështetur nga disa vende të tjera (mes tyre edhe Shqipëria), menjëherë pas vendimit të Rosisë për njohjen e dy rajoneve separatiste Luhansk dhe Donietsk. USG Rosemary DiCarlo informoi mbi situatën. Morën pjesë me të drejtë fjale Ukraina, si vend i prekur drejtpërdrejtë nga çështja, dhe Gjermania, si pjesëmarrëse e Formatit të Normandisë.

Duke iu referuar deklaratës së SP Gueterres, **DiCarlo** e cilësoi vendimin e Rosisë si shkelje të së drejtës ndërkombëtare, kartës së OKB-së dhe Marrëveshjes së Minskut. Sipas saj, gjendja humanitare në disa rajone po përkeqësohet, popullsia civile duhet ruajtur sa më shumë dhe të shmanget nga kërcënimet. Veprime të tilla të Rosisë mund të gjenerojnë konflikte të reja. P3 dënuan me terma të ashpër njohjen e Rosisë, duke e cilësuar si shkelje sovraniteti të një vendi tjetër, që mbart rreziqe përtej Ukrainës. Ato theksuan se Rusia hodhi poshtë tërësisht Marrëveshjen e Minskut dhe se ky veprim do të ketë pasoja të rënda ekonomike dhe financiare. Këtë qëndrim mbajti edhe Gjermania. SHBA tha se Rusia po kërkon një pretekst për luftë dhe se po ndërhyr ushtarakisht nën maskën e “forcave paqeruajtëse”. Duke iu referuar fjalimit të gjatë të Putinit dje, SHBA tha se Rusia po kthehet 100 vjet mbrapa në histori me pretendime territoriale. Rusia po teston sistemin ndërkombëtar, duke demonstruar se me forcë mund të zhvlerësojë OKB-në.

Kina mbajti një fjalim shumë të shkurtër, duke kërkuar vetëpërmbytje nga të gjitha palët dhe që çdo çështje të zgjidhet sipas Kartës së OKB-së. Shkaqet e situatës së tanishme janë shumë komplekse dhe duhen marrë parasysh shqetësimet e sigurisë së të gjithëve.

Rusia theksoi përpjekjet e saj për të shmangur humbjet njerëzore. Njohja e dy rajoneve duhej bërë më përpara, meqë ata kanë shpallur pavarësinë që në vitin 2014. Njohja erdhi si rezultat i mosangazhimit për zbatimin e Marrëveshjes së Minskut dhe hezitimit të Ukrainës për të dialoguar

direkt me përfaqësuesit e dy rajoneve. Njohja e dy republikave nuk ka impakt negativ në Marrëveshjen e Minskut, sepse rajonet kanë qenë të pavaruara që para nënshkrimit të marrëveshjes. Zbatimi i marrëveshjes duhet të vazhdojë.

Norvegjia, Irlanda, Kenia dhe Gana, dënuan qartazi shkeljen e sovranitetit të Ukrainës. Interesant ishte fjalimi i Kenias, që “thumboi” ish-vendet kolonialiste për caktimin arbitrar të kufijve të vendeve afrikane. Megjithatë vendet e Afrikës po shohin drejt së ardhmes, duke hequr dorë nga pretendimet që lidhen me të shkuarën. Brazili, India, EBA dhe Gaboni mbajtën qëndrim të tërhequr, sikur të mos kishte ndodhur gjë.

Shqipëria dënoi ashpër njohjen e dy republikave, si shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe Marrëveshjes së Minskut. Rusia, tha Ambasadori Hoxha, ka shkelur çdo agazhim që mori katër ditë më parë në sallën e KS. Duke theksuar se Shqipëria njeh sovranitetin e Ukrainës në kufijtë ndërkombëtarë të saj, ai evidentoi rrezikun e eksportimit të këtyre modeleve edhe në rajone të tjera të Evropës.

Ukraina dënoi veprimet dhe tha se do të vazhdojë përpjekjet e saj. Duke shprehur indinjatë për qëndrimin e tërhequr të disa vendeve, tha se “KS nuk është prekur nga virusi i Covid- it, por nga virusi i Kremlinit”.

Siria - Në datën 21 shkurt 2022 u publikua Raporti i 77-të i Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e disa rezolutave të KS për Sirinë. Raporti përfshin të dhëna nga burime të OKB-së (për periudhën dhjetor 2021- janar 2022) dhe qeveria e Sirisë.

Raporti evidenton se nevojat humanitare vazhdojnë të rriten në të gjithë Sirinë. Shprehet nevoja për angazhimin e komunitetit ndërkombëtar dhe zgjerimin e ndihmës humanitare në kushtet kur miliona njerëz mbeten të zhvendosur brenda vendit. Raporti evidenton, gjithashtu, situatën e qindra fëmijëve të mbajtur në burgje.

Operacionet ndërkufitare të Kombeve të Bashkuara të autorizuar nga Këshilli i Sigurimit mbeten kritike për të siguruar që ndihma për shpëtimin e jetës të mund të arrijë miliona njerëz në nevojë. Operacionet ndërkufitare janë operacionet më të monitoruara dhe u nënshtrohen disa niveleve kontrolli për të siguruar një shkallë të lartë transparence.

SP nxit të gjitha palët që të respektojnë të drejtat e njeriut dhe ligjin ndërkombëtar humanitar, mbrojtjen e civilëve dhe infrastrukturën civile në kryerjen e operacioneve ushtarake. Pandëshkueshmëria e vazhdueshme për shkeljet dhe abuzimet serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare mbetet një shqetësim i madh dhe autorët duhet të mbahen përgjegjës. U bën thirrje palëve siriane të angazhohen në mënyrë konstruktive me të dërguarin e posaçëm të SP për rishikimin thelbësor të elementeve kushtetues dhe mundësuar një raund të shtatë të Komitetit Kushtetues. Po ashtu, i bën thirrje palëve siriane, atyre rajonale dhe ndërkombëtare që të angazhohen në procesin politik drejt një zgjidhjeje të konfliktit që i jep fund dhunës dhe

adreson aspiratat e popullit sirian në përputhje me rezolutën 2254 (2015). Prioriteti kryesor mbetet një zgjidhje politike.

22 shkurt

Republika e Afrikës Qendrore (RAQ/CAR) - Më 22 shkurt u zhvillua në KS takimi mbi gjendjen në CAR. Shtetet diskutuan mbi çështje si situata e sigurisë; zhvillimet politike; shkeljet e të drejtave të njeriut dhe abuzimet, përfshirja e Ëagner në sulme kundër civilëve, situata humanitare, puna e MINUSCA, si dhe regjimi i sanksioneve.

SRSNG Ndiaye përshkroi hapat e ndërmarrë për të rivendosur stabilitetin pas miratimit në shtator 2021 të Udhërrëfyesit për Paqe në CAR dhe kërkesës drejtuar Qeverisë për angazhim më konkret në zbatimin e tij. Ai iu referua situatës së përkeqësuar të sigurisë me përplasje të vazhdueshme, përfshirë regjistrimin e abuzimeve kundër grave dhe fëmijëve dhe rekrutimin e këtyre të fundit. Ai iu referua, gjithashtu, disa zhvillimeve pozitive lidhur me zgjedhjet lokale dhe dialogun republikan, por kërkoi një zbatim më rigoroz të Marrëveshjes Politike të 2019. Gjatë konsultimeve ai iu referua edhe ndërprerjes së sinjalit të aparaturave të përdorura nga MINUSCA, duke sjell probleme në transport.

Sekretari Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare për Rajonin e Liqeneve të Mëdhenj, João Samuel Caholo, foli për sfidat që pengojnë përpjekjet e qeverisë për të zbatuar Udhërrëfyesin, përfshirë kufizimet financiare. Ai shprehu shqetësimin se kufizimet e burimeve mund të ndikojnë në mbajtjen e zgjedhjeve lokale gjithëpërfshirëse dhe të besueshme, të planifikuara për në 11 shtator 2022, pas tre dekadave. Ai bëri thirrje edhe për adresimin e nevojave humanitare në rritje dhe mbështetjen e kapaciteteve institucionale të qeverisë. Në këtë kontekst, ai i kërkoi Këshillit të punojë me autoritetet për të sjellë reforma në sektorin e sigurisë.

Bertino Matias Matondo, Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Afrikan, përshëndeti përpjekjet për vijimin e dialogut republikan të nisur nga qeveria, duke shprehur shpresën se dialogu i planifikuar në mars do të sjellë zgjidhje. Por ai theksoi nevojën për të adresuar sfidat që kanë të bëjnë me zhvillimin e dialogut republikan dhe ngriti alarmin për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe nevojën për të sjellë para drejtësisë autorët.

Franca u përqendrua te situata e sigurisë dhe ajo politike, te shkeljet e shumta të të drejtave të njeriut dhe te sulmet kundër civilëve. Fokus i veçantë iu dha abuzimeve nga Ëagner, si dhe bllokimit të emërimit të panelit të ekspertëve të komitetit të sanksioneve. Në të njëjtën linjë, Norvegjia ceku shkeljet e armëpushimit, sulmet kundër civilëve dhe punëtorëve humanitarë dhe, duke iu referuar grupit rus Ëagner, përmendi ndërhyrjet në sistemet e navigimit të MINUSCA, pengesat e misionit për të investiguar dhe mosplotësimin e panelit të ekspertëve. SHBA fokusoi ndërhyrjen në sulmet kundër MINUSCA dhe abuzimet (40% e totalit) e kryera nga Ëagner, duke theksuar se SHBA nuk mendon aspak heqjen e sanksioneve. SHBA kërkoi hetim të abuzimeve

dhe evidentoi rëndësinë e zgjedhjeve të ardhshme lokale. Mbretëria e Bashkuar u fokusua në efektet potencialisht negative të situatës së sigurisë në klimën politike, nënvizoi rreziqet nga sulmet kundër civilëve dhe abuzimeve ndaj minoriteteve, grave dhe fëmijëve, edhe nga grupi mercenar rus Ëagner. Më tej MB theksoi shkeljet e marrëveshjeve SOFA dhe sulmet kundër MINUSCA, përfshirë ndërprerjet e sinjalit të aparaturave të misionit. Edhe Irlanda u ndal në armëpushimin e parespektuar, zhvillimet politike, abuzimet kundër civilëve, përfshirë kundër grave dhe fëmijëve nga grupi Ëagner, duke kërkuar dënimin e autorëve. Po ashtu, përmendi situatën e rënduar humanitare dhe sulmet kundër punëtorëve humanitarë, sulmet kundër MINUSCA, si dhe rëndësinë e regjimit të sanksioneve dhe plotësimit të panelit të ekspertëve.

Kina dhe Rusia vendosën theksin e ndërhyrjeve të tyre në një serë masash pozitive që Qeveria ka ndërmarrë për të përmirësuar situatën e sigurisë dhe atë politike, duke vënë në fokus nevojën që komuniteti ndërkombëtar të ndihmojë vendin dhe të heqë regjimin e sanksioneve. Rusia në veçanti iu përgjigj me një gjuhë të ashpër akuzave për abuzimet dhe krimet e Ëagner, duke sulmuar për hipokrizi vendet perëndimore. Grupi A3 mbajti një qëndrim mjaft të ekuilibruar, por iu bashkua Kinës dhe Ruisë në thirrjen për heqjen e sanksioneve kundër vendit.

ZvPerfaqësuesja e Përhershme Dautllari theksoi se pavarësisht armëpushimit, situata e sigurisë në CAR është përkeqësuar nga përplasjet e vazhdueshme, ndërsa u bëri thirrje të gjitha palëve për t'u riangazhuar në dialog në bazë të Marrëveshjes Politike për Paqe dhe Pajtim të vitit 2019. Shprehu shqetësim të thellë për raportet mbi shkeljet dhe abuzimet me të drejtat e njeriut të kryera nga të gjitha palët, përfshirë vrasjet e civilëve dhe dhunën seksuale ndaj grave dhe fëmijëve. Bëri thirrje për hetimin e këtyre rasteve dhe për llogaridhënie nga autorët. Shqipëria foli edhe për efektet e situatës së paqëndrueshme të sigurisë në frontin humanitar, ndërsa iu referua kushteve të vështira të operimit të agjencive humanitare, por edhe të vetë MINUSCA-s në vend. Bëri thirrje për plotësimin e Panelit të Ekspertëve, të cilët mbështesin punën e Komitetit të Sanksioneve.

Irak/Kuvajt: Këshilli u mbledh për të shqyrtuar raportin përfundimtar të Komisionit të Shpagimeve të Kombeve të Bashkuara (UNCC). Infomoi Presidenti i Këshillit Drejtues të UNCC, z. Michael Gaffey.

Këshilli miratoi njëzëri projekt-rezolutën e paraqitur nga Mbretëria e Bashkuar 2621 (2022), e cila vendosi se UNCC ka përfunduar mandatin dhe se Iraku ka përmbushur detyrimet e tij ndërkombëtare për të shpague të gjitha kërkesat për zhdëmtimin të mbështetura nga UNCC. Në ushtrimin e aktivitetit të tij për gati 31 vite, Komisioni ka shlyer në shpagime rreth 1.5 milion kërkesa (nga 2.7 milion të tilla), duke kapur shifren e \$52.4 miliardë (nga \$352.5 miliardë të kërkuara).

Të gjitha vendet anëtare përshëndetën përmbushjen e mandatit të UNCC-së dhe shklyerjen e detyrimeve ndërkombëtare nga ana e Irakut. Gaffey u shpreh se ky ishte rasti i parë i shlyerjes së suksesshme të dëmeve dhe humbjeve të shkatërkura nga lufta dhe theksoi rëndësinë e këtij

precedenti. Ndërhyrjet nga anëtarët e Këshillit ishin unanime në përshëndetjen e tyre të përfundimit me sukses të punës së UNCC-së dhe bashkëpunimit midis Irakut dhe Kuvajtit, si dhe theksuan rëndësinë historike të ngjarjes.

Ambasadori Hoxha theksoi rëndësinë historike të kësaj arritjeje, duke përgëzuar Irakun për angazhimin dhe bashkëpunimin. Gjithashtu, shfrytëzoi rastin për t'iu kujtuar të gjithëve kostot e luftës dhe agresionit, dhe nevojën për të parandaluar dhe dhënë fund luftërave.

Sahel - Këshilli i Sigurimit diskutoi mbi luftën kundër terrorizmit në Sahel, me kërkesë të Francës. Kjo e fundit informoi anëtarët e Këshillit mbi rikonfigurimin e operacioneve ushtarake franceze në Sahel. Ajo informoi se më 17-18 shkurt Bashkimi Evropian (BE) dhe Bashkimi Afrikan mbajtën një samit dhe dolën me një deklaratë ku thuhej se për shkak të pengesave nga autoritetet e Malit, Operacioni Barkhane dhe Task Forca Takuba nuk kanë kushtet operative dhe ligjore për të vazhduar efektivisht angazhimin e tyre ushtarak në luftën kundër terrorizmit në Mali. Franca njoftoi vendimin për të filluar tërheqjen ushtarake nga territori i Malit. Megjithatë, siguroi ajo, veprimet kundër terrorizmit në rajonin e Sahelit do të vazhdojnë. Franca nuk priste ndonjë diskutim pasi kjo ishte për transparencë nga ana e tyre, por disa anëtarë morën fjalën për vërejtje të lehta.

Vendet e njëmendta e përdorën këtë mundësi për t'i treguar mbështetje Francës për transparencën dhe përkushtimin ndaj Sahelit. Anëtarët ngritën shqetësime në lidhje me Misionin e Kombeve të Bashkuara për Stabilizimin e Integruar Shumëdimensional në Mali (MINUSMA) duke u shprehur se është e nevojshme të minimizohet ndikimi i tërheqjes së Francës. Rusia e shfrytëzoi këtë mundësi për të sulmuar Francën duke deklaruar se ajo po e braktis Malin.

Shqipëria ngriti shqetësime për situatën e sigurisë dhe tregoi mbështetje për veprimet e përbashkëta kundër terrorizmit të ndërmarra nga partnerët ndërkombëtarë dhe rajonalë në Sahel. Duke marrë parasysh rikonfigurimin e operacioneve ushtarake të Francës, Shqipëria inkurajoi bashkëpunimin e ngushtë me shtetet fqinje dhe theksoi domosdoshmërinë për të mbështetur MINUSMA.

23 shkurt 2022

MEPP - Këshilli mbajti mbledhjen e përmuajshme mbi “Gjendjen në Lindjen e Mesme, duke përfshirë çështjen palestineze”. Tor Ëennesland, Koordinatorin e Posaçëm të OKB për Procesin e Paqes në Lindjen e Mesme përditësoi vendet anëtare të Këshillit. Gjendjen në terren ai e cilësoi si “përkeqësim destabilizues”. Ndërhyrjet e anëtarëve u ndalën kryesisht në gjendjen e tensionuar në Sheik Jarrah, në dhunën në rritje të kolonëve izraelitë dhe nevojën për llogaridhënie për këtë dhunë.

Ra në sy se SHBA doli me një qëndrim të fortë kundër së kolonëve dhe kërkoi që të gjithë shkelësit e ligjit, palestinezë apo izeralitë, të vihen para drejtësisë, Kërkesa për llogaridhënie u bënë edhe nga vende të tjerë si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Meksika, Rusia, Norvegjia dhe Kina.

Shqipëria theksoi mbështetje për zgjidhje të konfliktit në bazë të së drejtës ndërkombëtare. Ambasadori Hoxha shprehu shqetësim për masat e njëanshme që pengojnë një zgjidhje me dy shtete dhe mundësinë e bashkëjetesës në paqe.

Ukraina - Në takimin e Asamblesë së Përgjithshme u trajtua “Situata në territoret e pushtuara përkohësisht në Ukrainë”. Kjo çështje debatohet çdo vit në muajin shkurt, në kuadrin e përvjetorit të ankesimit të Krimesë nga forcat ruse në vitin 2014. Nisur nga situata aktuale Ukraina u përfaqësua me Ministrin e Jashtëm Dimitry Kouleba, Britania e Madhe dhe Gjermania në nivelin e Ministrisë të Shtetit në MPJ.

Presidenti i AP bëri thirrje për dialog, si e vëmë në mendje mënyrë për zgjidhjen e konfliktit. Sekretari i Përgjithshëm Gueterres dënoi agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës dhe njohjen e disa territoreve në lindje të Ukrainës si entitete të pavarura, duke i quajtur cënim të Kartës së OKB-së dhe të së drejtës ndërkombëtare. Ai u shpreh i gatshëm për vënien në dispozicion të mekanizmave të OKB-së dhe shfrytëzimin e çdo kanali diplomatik që palët të ulen në tryezën e bisedimeve.

Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Kouleba, paraqiti situatën e vështirë të vendit, ndaj të cilit ka filluar një agresion masiv ushtarak. Shprehu vendosmërinë për të vazhduar përpjekjet në mbrojtje të sovranitetit, si dhe gatishmërinë për bisedime në formate të ndryshme. Ai vlerësoi propozimin e fundit të Presidentit Zelenski për bisedime në formatin: P5 (vendet anëtare të KS të OKB-së), Gjermania, Turqia dhe Ukraina.

SHBA e quajti Rusinë shtet agresor dhe theksoi se është në dorën e Putinit të zgjedhë mes rrugës së paqes apo të luftës.

Ambasadori Hoxha dënoi vendimin e Rusisë për njohjen e rajoneve si shtete më vete. Vuri në dukje se agresioni ushtarak i Rusisë në Ukrainë mund të ketë pasoja të paparashikueshme. Modele të tilla nuk duhen lejuar të eksportohen në Evropë apo përtej saj. Gjithashtu, bëri thirrje për revokimin e vendimit të njohjes dhe rikthimin në tryezën e bisedimeve.

Jemeni – Me kërkesë të Rusisë dhe EBA u zhvillua një takim i mbyllur me praninë e të Dërguarit të Posaçëm për Jemenin, ku u diskutua impakti humanitar i paqëllimshëm i sanksioneve ndaj Jemenit, si dhe efekti i tyre mbi procesin politik. Grundberg njoftoi se së shpejti do të zhvillojë një vizitë në Riad në kërkim të mbështetjes saudite për procesin e konsultimeve që do të nisë më 7 mars 2022. Ai njoftoi se mbetet i angazhuar për prezantimin e Udhërrëfyesit për Jemenin me qasje në shtyllën politike të konfliktit dhe atë të sigurisë e ekonomike. Gjithashtu, ai njoftoi se udhërrëfyesi i përgjigjet mandatit të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm për Jemenin dhe nuk nënkupton përfshirjen në negociatat mes shteteve për draft-rezolutat. Kjo qasje u mbështet nga shumë vende anëtare.

Ambasadori Hoxha konfirmoi se nuk ka zgjidhje ushtarake për Jemenin dhe nënvizoi nevojën për një armëpushim kombëtar të menjëhershëm. Ai vërejti nevojën për forcimin e embargos së armëve dhe e mirëpriti tekstin e paraqitur nga Mbretëria e Bashkuar (shiko më poshte).

Po në datë 23.02.2022, me kërkesë të Trojkës së Ligës Arabe u zhvillua një VTC për të diskutuar mbi sulmet e vazhdueshme të Huthëve ndaj EBA dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite. Në takim, Shqipëria mori pjesë në nivel Përfaqësuesi të Përhershëm.

Për deklaratat e mbajtura në mënyrë të vazhdueshme ndaj konfliktit në Jemen dhe impaktit të tij rajonal, si dhe për qëndrimin që Shqipëria mbajti në negociata ndaj Huthëve si grupim terrorist dhe akteve të tyre të terrorit që reflektohen në PP 4 të tekstit, Misioni i EBA në Nju Jork përveçse falënderoi Misionin, njoftoi se, ka njoftuar MPJ Al Nahyan për përpjekjet e Shqipërisë në këto dy pika kryesore për EBA.

Penëmbajtja britanike shtyu për ditën e hënë datë 28.02.2022 miratimin e projekt-rezolutës për rinovimin e mandatit të Komitetit 2140 (2014) të sanksioneve për Jemenin, për shkak të divergjencave ndërmjet vendeve anëtare lidhur me: (i) përcaktimin e Huthëve si grupim terrorist; (ii) impaktin e përcaktimit të Huthëve si grupim terrorist dhe referencave për Iranin në procesin politik; (iii) efektet humanitare të paqëllimshme të sanksioneve; (iv) referencat tek raporti i Panelit të Ekspertëve për Jemenin për nevojën e forcimit të embargos së armëve dhe eksportimit të mjeteve me përdorim të dyfishtë, si dhe për gratë, paqen dhe sigurinë, veçanërisht sa i përket dhunës seksuale në konflikte dhe rrezikut shumë të lartë të radikalizimit dhe përfshirjes së fëmijëve në konflikt.

DPRK - Këshilli i Sigurimit diskutoi raportin 90-ditor të Komitetit 1718 të Sanksioneve për Republikën Popullore Demokratike të Koresë të paraqitur nga kryesia norvegjeze e këtij komiteti. Diskutimi u fokusua: 1) në shkeljet e vazhdueshme të Rezolutave të KS-së nga DPRK për mospasurimin bërthamor dhe armët e shkatërrimit në masë, si dhe shkeljen e moratoriumit për raketat balistike me hedhje të ndërmjetme; 2) Vazhdimin e programit të pasurimit bërthamor dhe sofistikimit të teknologjisë bërthamore nga DPRK.

Vendet shprehën pakënaqësinë ndaj mungesës së unitetit të KS-së në dënimin e akteve të rrezikshme dhe të paligjshme të DPRK dhe shkeljes së sanksioneve ndaj DPRK nga ana e shumë vendeve, veçanërisht për naftën, qymyrin, teknologjinë etj., sic e thotë edhe raporti i Panelit të Ekspertëve. Po ashtu, folësit vunë në dukje vazhdimin e izolimit të vendit për shkak të politikave drakoniane në përgjigje të Covid-19 dhe investimit në ushtri dhe jo në adresimin e situatës së rëndë humanitare në vend. Shqetësim mbetet mungesa e qasjes së Koordinatorit Rezident në DPRK. Të gjithë anëtarët bënë thirrje për angazhim diplomatik dhe dialog pa kushte nga ana e regjimit në DPRK, në dobi të realizimit të denuklearizimit të tërësishëm, të pakthyeshëm dhe të verifikueshëm të Gadishullit Korean. Me pikat e mësipërme, nuk u bashkuan Rusia dhe Kina, të cilat dhe njëherë

përmendën se politika e sanksioneve nuk është dobiprurëse dhe se drafti ruso-kinez mund të jetë një rrugë me krye në kontekstin e diskutimeve për DPRK.

Shqipëria dënoi shkeljet e regjimit të mospasurimit bërthamor nga DPRK, intensifikimin e testeve balistike dhe shkeljen e moratoriumit të 2018. Ajo vërejti karakterin e izoluar të regjimit dhe dënoi investimet e tij në ushtri dhe jo në adresimin e situatës humanitare në vend. Gjithashtu, bëri thirrje për rikthim tek dialogu dhe diplomacia. Nga ana tjetër, Shqipëria bëri thirrje për unitet të KS-së në adresimin e aktiviteteve të paligjshme të kryera nga DPRK.

Kryesia Norvegjeze e Komitetit të Sanksioneve dorëzoi më 25 shkurt në KS raportin e Panelit të Ekspertëve me rekomandimet përkatëse ku evidentohet shkelja e sanksioneve nga DPRK dhe evazioni ndaj sanksioneve mbi DPRK nga ana e vendeve si Kina, Rusia, Indonezia, etj., vazhdimi i programit proliferues nga ana e DPRK, impakti humanitar i masave të regjimit në përgjigje të Covid-19 dhe situata e rëndë në vend.

Paneli i ekspertëve ka propozuar një sërë sanksionesh ku më kryesoret janë: Përfshirja në listen e sanksioneve të një diplomati të DPRK në Moskë, i cili merret me aktivitete proliferuese, kufizimet detare dhe thellimi i masave shtrenguese për naftën dhe qymyrin. Paneli vlerëson si hapa pozitive zhbllokimin e kanaleve bankare dhe raportimin e OCHA një herë në gjashtë muaj.

Gjithashtu, më 25.02.2022, Irlanda depozitoi tek Presidenca Ruse kërkesën në emër të Shqipërisë dhe 36 vendeve të tjera, për mbajtjen në agjendën e KS-së të DPRK edhe për këtë vit.

24 shkurt 2022

UNAMI - Këshilli i Sigurimit shqyrtoi dy raporte, atë të UNAMI-t në lidhje me zhvillimet e fundit në Irak, dhe tjetrin mbi çështjen e të zhdukurve kuvajtjanë dhe humbjes së pasurisë kuvajtjane si pasojë e pushtimit nga Iraku në 1991. E Dërguara e Posaçme dhe Kryetarja e misionit UNAMI, Jeanine Hennis-Plasschaer, ishte ftuar të përditësojë Këshillin.

Ngërçi politik pas zgjedhjeve të mbajtura në tetor 2021, çertifikimi i tyre në dhjetor 2021 dhe nevoja për përfundimin e procesit ishin pikat kryesore të takimit. Plasscharet vuri në dukje se me shtyrjen e votimit të 7 shkurtit për presidentin e ri po vonohet krijimi i i qeverisë brenda afatave kushtetuese. Ajo nuk shprehu optimizëm për vullnetin e palëve për gjetjen e një kompromisi të shpejtë. Ky boshllëk kushtetues nuk tregon ndjeshmëri ndaj kërkesave dhe aspiratave të irakenëve që dolën në protesta në 2019 dhe që presin akoma një qeveri të aftë që t'u bëjë ballë sfidave të mrehta me të cilat përballlet Iraku. Një ndër këto sfida mbetet rreziku i ISIS, që vazhdon të përfitojë nga ngërçi politik për të zgjeruar veprimtarinë terroriste.

Ndërhyrjet e anëtarëve të Këshillit kishin një frymë më pozitive dhe përgëzuese për arritjet e Irakut kohët e fundit, me gjithë sfidat e medha me të cilat është përballur, sikurse është ISIS. Ka një dakordësi të rrallë në radhët e Këshillit në mbështetje të rolit të UNAMI, puna e të cilit vlerësohet

me nota të larta për sa i takon përparimit në rimëkëmbjen e vendit dhe dialogut me entitetet nën-federale, sidomos me Erbilin. U vlerësua shumë mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe çertifikimi i rezultateve të tyre, si dhe fryma e bashkëpunimit për krijimin e një qeverie të re.

Shqipëria shprehu vlerësim për gjetjen dhe riatdhesimin e eshtrave të një numri qytetarësh kuvajtianë. Ajo shprehu shqetësimin për ngërçin në zgjidhjen e presidentit të ri, theksoi nevojën e respektimit të afateve kushtetuese për krijimin e qeverisë së re, si dhe nevojën për dialog dhe bashkëpunim mbi vijat sektare për të çuar përpara proceset demokratike në vend, në shërbim të interesit të përbashkët.

25 shkurt 2022

Ukraina - KS zhvilloi një takim urgjent për të votuar projekt-rezolutën e iniciuar nga Shqipëria dhe SHBA lidhur me agresionin ushtarak rus në Ukrainë. Projekt-rezoluta u bashkëponsorizua nga 81 vende anëtare të OKB-së. Rusia e bllokoi përmes vetos. Rezultati i votimit ishte 11 pro, 3 abstenime (Kina, India, EBA) dhe 1 kundra (Rusia).

Projekt-rezoluta kishte synim parësor izolimin e Rosisë në KS. Që prej qarkullimit të draftit të parë, vendet e njëmendta kanë bashkërenduar punën lobuese, si me vendet e KS për të fituar mbështetje në votim, ashtu edhe me vendet e tjera për të rritur mbështetjen maksimale në bashkësponsorizim. Brenda KS puna u fokusua kryesisht mbi Kinën, Indinë, EBA dhe Gabonin. Synimi kryesor ishte të shmangej vota kundër e këtyre vendeve, në mënyrë që Rusia të mbetet e vetme. Drafti u ndryshua disa herë, duke marrë parasysh kërkesat e këtyre vendeve. Negociatat më të gjata dhe më të vështirat rezultuan me Kinën, nisur edhe nga fakti i përfshirjes së niveleve më të larta shtetërore në Pekin dhe Departamentit të Shtetit në Ëashington. Fillimi i takimit u shty dy herë, për të mundësuar një tekst të pranueshëm dhe të sigurohej abstenimi i Kinës. Në të njëjtën kohë, në një rrafsh më të gjerë, vendet e njëmendta u sensibilizuan për të siguruar mbështetje të bashkësponsorizuesve, me një ndarje pune sipas zonave gjeografike. Në fund u arrit bashkësponsorizimi i 81 vendeve, çka mund të konsiderohet një rezultat i shkëlqyer duke pasur parasysh si kohën si aktorët e përfshirë.

SHBA, Shqipëria, Gaboni, Meksika dhe Brazili mbajtën fjalë para dhe pas votimit, ndërsa vendet e tjera vetëm një “sqarim vote” pas votimit. SHBA, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar dënuan agresionin ushtarak rus në Ukrainë, kërkuan tërheqjen e trupave ushtarake ruse dhe rikthim në bisedimet diplomatike. Rusia, sipas tyre, është e vetme në arenën ndërkombëtare, çka reflektohet dhe në KS. Bënë thirrje për mbështetje të rezolutës. Këto qëndrime patën edhe vendet e tjera (Irlanda, Meksika, Norvegjia, Brazili, Gana, Kenia, Gaboni).

Ambasadori Hoxha dënoi ashpër agresionin rus, bëri thirrje për tërheqje të trupave pa kushte, për asistencë humanitare për njerëzit në nevojë, si dhe për riaktivizimin e bisedimeve diplomatike. Kërko mbështetje për projekt-rezolutën si një kontribut konkret i KS për qetësimin e situatës.

Kina theksoi se zhvillimet kanë arritur në një pikë të padëshirueshme. Respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial, si dhe i Kartës së KB mbeten të rëndësishme. Ukraina duhet të shërbejë si urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit. Sanksionet nuk kanë dobi, madje vështirësojnë më tej klimën mes shteteve. Nevojitet një Koncept Gjithëpërfshirës i Sigurisë dhe duhet të dilet nga mentaliteti i Luftës së Ftohtë.

India vazhdoi me qëndrimin e saj të zbehtë, ku edhe pas fillimit të agresionit rus ndjehet vetëm “deeply disturbed”. U bëri thirrje palëve për rikthim në tryezën e bisedimeve.

EBA theksoi mbështetjen për parimet e përgjithshme të projekt-rezolutës, si dhe të sovranitetit dhe integritetit territorial të çdo vendi anëtar të OKB-së. La të kuptohet mes rreshtave, se EBA abstenoj, meqë dihet bllokimi i projekt-rezolutës nga Rusia.

Rusia hodhi poshtë të gjitha akuzat ndaj saj, duke i cilësuar veprimet si “operacione ushtarake për mbrojtjen e popullsisë ruse në Ukrainë”. Dënoi perëndimin për dështimin e Marrëveshjes së Minskut dhe për armatosjen e Ukrainës. Rregjimi ukrainas ka bërë krime kundër popullsisë në Donbas. Nuk mund të mbështetet një rezolutë mbi Ukrainën, që nuk u referohet këtyre krimeve.

Ukraina shprehu mirënjohje ndaj të gjitha vendeve që po e mbështesin, si në KS ashtu edhe në organizamte tjera të OKB-së. Duke iu referuar Nenit 34 të Kartës së OKB-së, kërkoi që Rusia të mos merrte pjesë në votimin e rezolutës, meqë është palë në konflikt. Gjithashtu, kërkoi që Rusia të mos ushtronte presion ndaj SP Gueterres, për shkak të dënimit që ky po i bën agresionit rus në Ukrainë.

Rezultati i votimit tregoi izolimin e Rusisë në KS, duke mos siguruar asnjë votë tjetër kundër projekt-rezolutës. Një rezultat i tillë bën të besosh për një mbështetje të gjerë të rezolutës në AP javën e ardhshme. Abstenimi i Kinës nxjerr në pah ndjeshmërinë që ka ndaj parimit të sovranitetit dhe kundërshtimin ndaj rolit të NATO-s. India vazhdon me një qëndrim të tërhequr dhe në negociatë nuk është e qartë se çfarë kërkon (*Rusia e mbështet Indinë në çështjen e Kashmirit, si dhe jep pothuajse 2/3 e armatimit total të saj*). EBA ka zgjedhur të mbajë një qëndrim të heshtur ndaj agresionit rus, megjithë demarshet e forta të SHBA dhe MB (*Rëndësi të madhe për EBA paraqet OPEC+, nismë që nuk mund të funksionojë pa Rusinë. EBA ka shqetësime lidhur me çështjet e sigurisë, duke pretenduar se SHBA është tërhequr nga Gjiri i Vitet e Fundit. Kjo ka bërë që të diversifikojë alenacat e saj, duke synuar një afrim me Rusinë*).

Agresioni rus ka nxjerrë poërfundimisht SP të OKB-së nga asnjënjësia. Ai kërkoi falje publike në takimin e KS më dt.25 shkurt për “vlerësimin e gabuar të situatës, meqë nuk e besoja se Rusia do të sulmonte Ukrainën”. Dje SP ka emëruar dipomatën sudanez Amin Aëad si Koordinator të OKB-së për Krizën e Ukrainës. Aëad do të ketë në fokus asistencën humanitare dhe qetësimin e situatës.

Këshilli i Sigurimit, me iniciativën e vendeve penëmbajtëse, Shqipërisë dhe SHBA, do kërkojë që kjo projekt rezolutë të kalojë në Asamblenë e Përgjithshme për një votim të gjithë anëtarësisë së OKB-së, ku Rusia nuk ka veto.

Komiteti sipas Rezolutës 1540 - Këshilli i Sigurimit miratoi me 15 vota shtyrjen deri me 30 nëntor 2022 të mandatit të Komitetit të Monitorimit të Armëve Bërthamore, Biologjike dhe Kimike (sipas Rezolutës 1540) dhe Grupit të tij të Ekspertëve. KS e zgjati mandatin e Komitetit për 9 muaj, duke miratuar njëzëri Rezolutën 2622 (2022).

Disa prej shteteve anëtarë të Këshillit debatuan natyrën teknike të këtij rinovimi pas votimit me unanimitet. Rusia, shprehu mbështetjen e delegacionit të tij për natyrën parandaluese të rezolutës, por theksoi se ka shqetësime serioze në lidhje me procesin e punës së Komitetit. Ajo bëri thirrje që gjatë procesit të rishikimit të merren parasysh kontributet e pjesëmarrësve kryesorë. Kina shpreson se Komiteti do të përmbushë mandatin e tij dhe se qendrimet e të gjitha shteteve do të merren parasysh. Meksika, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit, tha se zgjatja e mandatit do të lejojë përpjekje të gjera për zbatimin e rezolutës 1540 (2004). SHBA mirëpritën zgjatjen e mandatit, i cili do të lejojë funksionin e vazhdueshëm të Komitetit si një mjet i fuqishëm për të parandaluar rënien e armëve të shkatërrimit në masë në duart e aktorëve joshitetërorë. SHBA u shprehen se do t'i japin përparësi detyrimeve të shteteve sipas rezolutës 1540 (2004) dhe se do të rrisin mbështetjen e tyre për asistencën dhe aktivitetet në terren. Mbretëria e Bashkuar shprehu mbështetje të fortë për Rezolutën 1540, duke theksuar se ajo ka qenë një pjesë e rëndësishme e arkitekturës shumëpalëshe për mospërhapjen që nga miratimi i saj.

27 shkurt 2022

Këshilli votoi sot me shumicë votash, një rezolutë të paraqitur nga Shqipëria dhe SHBA-të, për të thirrur një sesion të jashtëzakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme për të diskutuar mbi situatën dhe për të shqyrtuar një rezolutë në këtë forum, pasi rezoluta e paraqitur nga bashkëpenmbajtësit në Këshill nuk u miratua si rezultat i vetos nga Rusia.

Vendet anëtare mbajtën pozicione thuajse të njëjta me ato të takimit të mëparshëm të Këshillit. Ambasadori Hoxha theksoi se sesioni i jashtëzakonshëm i AP-së të OKB-së ka të bëjë me dënimin e një lufte të paprovokuar, ka të bëjë me ruajtjen e Kartës së OKB-së; ka të bëjë me dërgimin e një mesazhi të qartë dhe të fortë se çfarë është e pranueshme dhe çfarë jo, përfshirë për qytetarët rusë, të cilët duhet ta dëgjojnë botën!

Rusia duhet të ndalet në përpjekjen e saj për të thyer rendin e bazuar në rregulla ndërkombëtare për ta zëvendësuar atë me vullnetin e saj. Të gjitha shtetet anëtare, veçanërisht ato të voglat, që përbëjnë shumicën e OKB-së, duhet të kujtojnë se Ligji Ndërkombëtar, Rregullat dhe Karta e

OKB-së janë miku i tyre më i mirë, ushtria e tyre më e mirë, mbrojtja më e mirë, sigurimi i tyre më i mirë. Veprimet e Ruisë i minojnë ato!

Sesioni i jashtëzakonshëm do të fillojë punimet me datë 28 shkurt 2022.

#